

# NJË SINERGJI DREJTË PËRMBUSHJES SË OZHQ-VE





Autor: INDEP

Edituar nga: Ekipi i INDEP

Programi: Zhvillim i Qëndrueshëm

Publikuar: Prill 2023

Dizajni: KUKU Creative



**Zhvillimi i Qëndrueshëm**  
Sustainable Development

### **Instituti për Politika Zhvillimore - INDEP**

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.

Ky punim është publikuar me mbështetjen e Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH në emër të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ). Përmbajtja e këtij dokumenti, duke përfshirë opinionet e shprehura, përfaqësojnë opinionin e autorit(ve) dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht qëndrimin e Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH apo Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ).

---

## Përmbajtja

Hyrje.....	3
Mekanizmat në nivel qendror.....	4
Mekanizmat në nivel lokal.....	5
Avancimi i bashkëpunimit ndërmjet nivelit qendror dhe lokal.....	6
Konkludime.....	8
Rekomandime.....	9

## Hyrje

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) dhe Agjenda 2030 përmbajnë obligime të ndërlidhura të cilat kërkojnë angazhim të të gjitha niveleve institucionale si dhe të shumë sferave të shoqërisë. Rrjedhimisht, “është kritike që për përmbushjen e OZHQ-ve të ketë kontribut aktiv dhe dhe pronësi të qeverive lokale dhe rajonale, bashkë me qeverinë kombëtare, sektorin privat dhe shoqërinë civile”.<sup>1</sup>

Në veçanti, angazhimi më i madh i nivelit komunal është esencial duke marrë parasysh se “rreth 60% e zbatimit të OZHQ-ve bie mbi barrën e pushtetit lokal dhe nga 169 Synime (Targete) të definuara, janë 99 prej tyre relevante për komunat e Kosovës”.<sup>2</sup> Deri tani nuk ka pasur angazhim të theksuar të komunave me përjashtim të aktiviteteve të përkrahura nga organizatat ndërkombëtare dhe vendore.

Në anën tjetër, Këshilli për Zhvillim të Qëndrueshëm (Këshilli) si organ nacional për bashkërendimin e përmbushjes së OZHQ-ve në Kosovë është themeluar në vitin 2019 brenda Kuvendit të Republikës së Kosovës, por si rrjedhojë e zhvillimeve politike, në veçanti zgjedhjeve të shpeshta parlamentare, si dhe periudhës së Pandemisë COVID-19 Këshilli nuk kishte performuar në nivelin e duhur deri në pjesën e dytë të vitit 2021, kur Këshilli u konsolidua me përbërjen e re, dhe që nga atëherë ka qenë mjaft aktiv. Një zhvillim tjetër pozitiv është se Qeveria e Republikës së Kosovës, tani ka përfshirë OZHQ-të brenda Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2030.

Brenda këtyre zhvillimeve pozitive drejt përmbushjes së OZHQ-ve, mungon një koordinim dhe bashkëpunim i mirëfilltë ndërmjet nivelit qendror dhe lokal. Ndonëse, Asociacioni i Komunave të Kosovës është i përfaqësuar në Këshill, kjo duket të jetë e pamjaftueshme për të shfrytëzuar potencialin e madh që komunat kanë drejt përmbushjes së OZHQ-ve.

Ky punim bën një vlerësim të mekanizmave aktual të nivelit qendror dhe lokal me qëllim të rekomandimit të zgjidhjeve optimale për avancim të bashkëpunimit dhe shfrytëzimit të pozicionit, punës dhe të dhënave nga komunat për përmbushje të OZHQ-ve. Punimi fillimisht do të bëjë një përshkrim të mekanizmave dhe proceseve të palëve institucionale me potencial të përfshirjes në përmbushje të OZHQ-ve. Më pas do të bëjë një analizë të mangësive dhe mundësive brenda këtyre mekanizmave dhe propozon opsione për bashkëpunim më të mirë dhe shfrytëzim efektiv të resurseve në dispozicion për përmbushje të OZHQ-ve.

---

<sup>1</sup> Shih në: <https://www.vng-international.nl/sites/default/files/DEFINITIEF-E-2021GGBrochure-web.pdf>

<sup>2</sup> Shih në: <https://indep.info/ozhq-te-perballe-fusheveprimtarise-dhe-misionit-te-komunave-te-kosoves/>

## Mekanizmat e nivelit qendror

Pas përfundimit të mandatit të Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit në vitin 2015, Organizata e Kombeve të Bashkuara inicoi procesin për hartimin e OZHQ-ve. Në këtë proces ishte përfshirë edhe shoqëria kosovare përmes një numri të aktiviteteve të mbështetura nga Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNKT) dhe agjencitë e saj.


Rrjedhimisht, në janar të vitit 2018, Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi një rezolutë përmes të cilës zotohet për zbatimin e OZHQ-ve dhe Agjendës 2030 në Kosovë. Kjo rezolutë kërkon angazhim konkret nga shtatë (7) komisione parlamentare, të cilat mbulojnë shumicën e OZHQ-ve. Si dhe, Rezoluta kërkon raportim të Qeverisë rreth zbatimit të Strategjisë për Zhvillim Kombëtar 2016 – 2021.

Më tutje, në mars të vitit 2019, Kuvendi miraton vendimin për themelimin e Këshillit për Zhvillim të Qëndrueshëm me përbërje të shtatë komisioneve parlamentare, si dhe përfaqësues nga Zyra e Presidencës, Zyrës së Kryeministrit, Agjencisë Statistike të Kosovës, Ekipeve të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, Rrjetit të Grave të Kosovës dhe rrjete tjera të shoqërisë civile.

Vendimi në fjalë nuk përfshin pjesëmarrjen e përfaqësuesve të komunave të Kosovës e as të Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK) në mënyrë eksplicite. Përveç kësaj, nuk është përfshirë as komisioni parlamentar që mbulon pushtetin lokal, që do të kishte siguruar një lidhmëri me nivelin lokal të pushtetit.

Pavarësisht vendimit, Këshilli në takime dhe evente ka ftuar rregullisht përfaqësuesin e AKK-së si dhe të Komisionit Parlamentar për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal. Këshilli në dy vitet e fundit ka zhvilluar një numër të aktiviteteve dhe eventeve, në disa prej tyre me pjesëmarrje të përfaqësuesit të AKK-së, por jo me fokus të bashkëpunimi me komunat me qëllim të përmbushjes së OZHQ-ve.

Në anën tjetër, Qeveria e Republikës së Kosovës në mars të vitit 2023 miratoi Strategjinë dhe Planin Kombëtar për Zhvillim 2030.<sup>3</sup> Ky dokument shpreh "përkushtimin për zbatimin dhe integrimin e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm".<sup>4</sup> Të gjitha



<sup>3</sup> Shih në <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/03/06032023-Strategjia-dhe-Plani-Kombetare-per-Zhvillim-2030.pdf>

<sup>4</sup> Shih në <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/03/06032023-Strategjia-dhe-Plani-Kombetare-per-Zhvillim-2030.pdf>

seksionet e këtij dokumenti i referohen OZHQ-ve përkatëse të cilat synohen të plotësohen nga masat e parapara në dokument.

### **Mekanizmat në nivel lokal**

Ministria e Pushtetit Lokal aplikon Sistemin për Monitorimin e Performancës Komunale (SMPK) në përputhje me kompetencat komunale që dalin nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale. Si rrjedhojë, “i tërë fokusi i SMPK-së është të vlerësohet puna e komunave të Republikës së Kosovës në përmbushjen e kompetencave kryesore në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale”.<sup>5</sup> Nga SMPK aktualisht mund të nxirren të dhëna të pakta që mund të shfrytëzohen për të pasur një pasqyrë më të qartë rreth përmbushjes së OZHQ-ve nga ana e komunave.

Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) si një organizatë joprofitabile, përfaqëson interesat e komunave të Republikës së Kosovës. Përveç strukturës menaxhuese, AKK përbëhet edhe nga 19 kolegji të cilat mbulojnë fusha të caktuara tematike brenda kompetencave të komunave. Kolegji të përbëra nga drejtorët e drejtorive përkatëse të komunave janë një forum i pashfrytëzuar për koordinim dhe mbledhje të të dhënave për nivelin qendror si dhe për përmbushjen e OZHQ-ve.

Dhe, struktura të vetëkuptueshme të nivelit lokal, janë komunat të cilat janë njësi themelore e vetëqeverisjes lokale. Komunat, siç u potencua më sipër, janë përgjegjës për zbatim të rreth 60% të OZHQ-ve por një numër shumë i vogël i kushtojnë vëmendjen e duhur OZHQ-ve. Vlen të përmendet Komuna e Vushtrisë e cila është e vetmja që ka realizuar një Raport Vullnetar Lokal për të vlerësuar nivelin e përmbushjes së OZHQ-ve nga kjo komunë. Kjo iniciativë e Komunës së Vushtrisë është bërë e mundur me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare dhe vendore.

Duhet potencuar se INDEP ka bërë një numër të publikimeve rreth OZHQ-ve, përfshirë edhe Planet për Lokalizimin e OZHQ-ve për disa komuna. Këto Plane janë esenciale për të orientuar punën e komunave drejt përmbushjes së OZHQ-ve që bien nën kompetencë të tyre.

---

<sup>5</sup> Shih në <https://indep.info/lexo-ketu/>

## Avancimi i bashkëpunimit ndërmjet nivelit qendror dhe lokal

Të gjitha të dhënat e mësipërme duke u nisur nga mbulimi i rreth 60% të OZHQ-ve nga niveli komunal, ekzistenca e SMPK-së si dhe kolegjiemet e AKK-së janë indikatorë të fushëveprimtimit, shtrirjes dhe mekanizmave të nivelit lokal për angazhim më të madh drejt përmbushjes së OZHQ-ve. Këto paraqesin një aset të pashfrytëzuar nga niveli qendror si për zbatim të OZHQ-ve ashtu edhe për raportim të përmbushjes së tyre.

Në bazë të kompetencave të tyre, Komunat e Republikës së Kosovës mbulojnë 99 nga 169 Synime (Targete) të OZHQ-ve. Një numër i këtyre synimeve janë të përfshira brenda planeve të punës së komunave, por nuk bëhet ndërlidhja e tyre me OZHQ-të. Rrjedhimisht, pasi nuk ka ndërlidhje me OZHQ-të përkatëse, nuk mund të ketë as raportim adekuat.<sup>6</sup>

Ngjashëm, SMPK mbulon të gjitha fushat e veprimtarisë së komunave sipas legjisllacionit në fuqi. Të dhënat e mbledhura nga SMPK mbulojnë në mënyrë indirekte vetëm një pjesë të OZHQ-ve. Mirëpo, me një rishikim të indikatorëve aktual të SMPK dhe futjes së indikatorëve të OZHQ-ve që janë relevant për komunat, SMPK mund të mbledh një numër të madh të të dhënave rreth përmbushjes së OZHQ-ve të cilat mund të shfrytëzohen nga niveli qendror për të pasur një pasqyrë më të qartë të këtij procesi.<sup>7</sup>

Prandaj, Këshilli dhe trupat përkatëse qeveritare duhet të avancojnë bashkëpunimin me organet komunale për t'i shfrytëzuar komunat si aset për përmbushjen dhe raportimin e OZHQ-ve në nivel të vendit. Në veçanti, Këshilli si organ nacional koordinues për përmbushje të OZHQ-ve duhet të shikojë mundësitë e rritjes së bashkëpunimit me strukturat e nivelit lokal në këtë drejtim.

Këshilli mund të krijojë një forum me disa prej kolegjiemeve të cilat mbulojnë një numër të madh të OZHQ-ve. Këto kolegjieme mund të ftohen në mbledhjet e Këshillit ose mund të krijohet një forum i ri për përmbushjen e OZHQ-ve në nivel lokal. Disa prej këtyre kolegjiemeve janë:

- Kolegjiumi për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
- Kolegjiumi për Zhvillim Ekonomik Lokal
- Kolegjiumi për Planifikim Hapsinor
- Kolegjiumi për Arsim
- Kolegjiumi për Energji
- Kolegjiumi për Menaxhim të Mbeturinave.

Duke marrë parasysh faktin se këto kolegjieme janë të përbëra nga drejtorët ose zyrtarët përgjegjës të këtyre fushave, ato janë një mekanizëm i jashtëzakonshëm për të koordinuar përmbushjen e OZHQ-ve. Njëkohësisht, po i njëjti mekanizëm ka qasje të

<sup>6</sup> Për më shumë shih pulbikimin e INDEP në: <https://indep.info/ozhq-te-perballe-fusheveprimtarise-dhe-misionit-te-komunave-te-kosoves/>

<sup>7</sup> Për më shumë shih pulbikimin e INDEP në: <https://indep.info/lexo-ketu/>



vazhdueshme në informata dhe gjendjen në teren në komunitat përkatëse, prandaj mund të bëjnë raportim të qartë dhe të plotë të përmbushjes së *Synimeve* të OZHQ-ve. Gjithashtu, përmes këtij forumi do të bëhej vetëdijësimi i drejtorëve dhe zyrtarëve të kolegjiumeve si dhe të stafit të tyre nëpër komuna. Gjithsesi, një forum i tillë duhet të paraprihet me sesione informuese dhe trajnime rreth OZHQ-ve për anëtarët e kolegjiumeve.

Ideale do të ishte, sikur të krijohesh një kolegjium i ri i përbërë nga tetë kolegjiumet të cilat mbulojnë numrin më të madh të OZHQ-ve. Në këtë kolegjium do të merrnin pjesë udhëheqësit e tetë kolegjiumeve përkatëse. Ky kolegjium mund të bëjë më pas do të kishte rol koordinues si në relacion me komuna ashtu edhe Këshillin dhe organet tjera të nivelit qendror.

Prandaj, Këshilli duhet të shikoj mundësitë e angazhimit të kolegjiumeve të AKK-së gjatë punës dhe aktiviteteve të Këshillit. Kjo do të siguronte një kanal të mirë të bashkëpunimit ndërmjet Këshillit si organ nacional koordinues dhe nivelit lokal. Mbi të gjitha, do të shërbente si për orientim të punës së komunave drejt përmbushjes të OZHQ-ve si dhe për raportim të progresit.

Ky bashkëpunim nuk duhet të shihet si ndonjë ndërhyrje nga niveli qendror në pushtetin e pavarur lokal, mirëpo si një sinergji, bashkëpunim dhe koordinim me përfitim të dyanshëm, dhe mbi të gjitha për tërë Republikën e Kosovës.

Me vullnet politik, Këshilli, në bashkëpunim me Komisionin për Administratë Publike, Pushtet Lokal, dhe Zhvillim Rajonal, mund të kërkojë nga Ministria e Pushtetit Lokal rishikimin e SMPK-së. Ky rishikim do të bëhej duke përafëruar indikatorët aktual me indikatorët të OZHQ-ve që janë relevant për komunitat. Në këtë mënyrë, do të orientohej puna e komunave drejt përmbushjes së OZHQ-ve paralelisht me zbatim të kompetencave që dalin nga legjislacioni përkatës. Po ashtu, të dhënat e mbledhura përmes indikatorëve të rishikuar, do të shërbenin për institucionet në nivel qendror për të vlerësuar përmbushjen e OZHQ-ve dhe për të raportuar progresin.



Media

## Konkludime

Punimi numëron një numër të mekanizmave ekzistues në nivel qendror dhe lokal të cilët mund të krijojnë një sinergji të jashtëzakonshme drejt përmbushjes së OZHQ-ve në nivel të vendit. Prej këtyre mekanizmave, vetëm Këshilli aktualisht është duke u marrë me një koordinim, mbikëqyrje dhe ngritje të vetëdijes rreth OZHQ-ve.

Në nivel lokal ekziston një aset i madh i pashfrytëzuar për të orientuar punën drejt përmbushjes së OZHQ-ve dhe në veçanti për të raportuar rreth përmbushjes së tyre. Kjo e fundit është në veçanti e rëndësishme pasi mjaft punë bëhet nga komunat në baza ditore që në mënyrë direkte ose indirekte shënon progres drejt përmbushjes së OZHQ-ve, mirëpo nuk raportohet kundrejt OZHQ-ve.

Prandaj, një iniciativë dhe vullnet politik nga ana e Këshillit për të angazhuar në të ardhmen kolegjiomet përkatëse do të ndikonte pozitivisht në rrugën e Republikës së Kosovës drejt integritit dhe raportimit të OZHQ-ve. Njëkohësisht, AKK dhe kolegjiomet duhet t'i përgjigjen pozitivisht ftesës së Këshillit për bashkëpunim, pasi ky bashkëpunim do të kishte ndikim pozitiv në performancën e drejtorive përkatëse dhe rrjedhimisht komunave të Republikës së Kosovës.

Ideale do të ishte edhe krijimi i një kolegjiomi të veçantë për koordinim të integritit dhe raportimit të OZHQ-ve për kolegjiomet tjera. Ky kolegjiom i ri, do të mund të shërbente si urë lidhëse me Këshillin.

Gjithashtu, inicimi i një rishikimi të indikatorëve të SMPK-së për të përfshirë indikatorë të OZHQ-ve do të ishte tejet përfitues për gjithë vendin. Këshilli do të kishte një pasqyrë të mirë të përmbushjes së OZHQ-ve nga niveli lokal, dhe Qeveria e Republikës së Kosovës mund të shfrytëzojë SMPK-në për të mbledhur të dhëna rreth progresit në zbatimin e Strategjisë dhe Planit Kombëtar për Zhvillim 2030.

Të dy këto iniciativa, pra angazhimi i kolegjiomeve dhe rishikimi i SMPK-ve automatikisht do të aktivizonin të gjitha strukturat komunale drejt një integriti më të mirë të OZHQ-ve në punën e të gjitha drejtorive komunale. Kjo më pas do të mundësonte edhe një raportim të fokusuar kundrejt OZHQ-ve.

## Rekomandimet

Në përputhje me konkludimet e mësipërme, rekomandohen veprimet e mëposhtme për të jetësuar një sinergji të re drejt përmbushjes së OZHQ-ve:

1. Këshilli të ndërmerr një iniciativë për angazhim të kolegjiemeve të AKK-së me qëllim të koordinimit rreth përmbushjes së OZHQ-ve, në veçanti të tetë (8) kolegjiemeve që janë më relevante për OZHQ-të;
2. Këshilli, në bashkëpunim dhe me mbështetje të organizatave ndërkombëtare dhe vendore, të organizojë seanca informuese ose trajnime për kolegjiemet e AKK-së rreth Synimeve (Targeteve) që bien nën kompetencat e kolegjiemeve përkatëse;
3. Këshilli të përfshijë kolegjiemet relevante në eventet të cilat i organizon varësisht prej temës dhe OZHQ-së së mbuluar nga eventet;
4. Qeveria e Republikës së Kosovës, në koordinim me Këshillin dhe me mbështetje të organizatave ndërkombëtare dhe vendore, të iniciojë rishikimin e indikatorëve të SMPK-së për të përfshirë indikatorët e OZHQ-ve;
5. Kolegjiemet e AKK-së të përgjigjen pozitivisht ndaj iniciativës së Këshillit për bashkëpunim drejt përmbushjes së OZHQ-ve;
6. Kolegjiemet e AKK-së të marrin pjesë në seancat informuese ose trajnimet, si dhe në eventet e organizuara nga Këshilli me qëllim të avancimit të përmbushjes së OZHQ-ve;
7. AKK të shqyrtojë mundësinë e krijimit të një kolegjiemi të veçantë për OZHQ-të për të koordinuar punën e kolegjiemeve tjera në përmbushjen e OZHQ-ve si dhe për koordinim me Këshillin.
8. Organizatat ndërkombëtare dhe vendore të fokusuara në mbështetjen e institucioneve drejt përmbushjes së OZHQ-ve të shqyrtojnë mundësitë e mbështetjes së kolegjiemeve të AKK-së në këtë drejtim.

Ky projekt financohet nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH në emër të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ).